



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)

DHE

UNITA ALBANIA

“Për bashkëpunimin në promovimin e pronësisë industriale, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare”.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë referuar si “DPPI”), përfaqësuar nga znj. Maria Solis Kapedani, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm,

në njërën anë,

dhe

UNITA Albania, (këtu e më poshtë referuar si “UNITA AL”) përfaqësuar nga z. Sokol Çili, në cilësinë e Presidentit,

Duke pasur parasysh Ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, për aq sa dispozitat e tij mbeten në fuqi, dhe në veçanti dispozitat që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;

Duke pasur parasysh Ligjin nr. 52/2025, “Për markat tregtare”, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për regjistrimin dhe mbrojtjen e markave tregtare;

Duke pasur parasysh Ligjin nr. 53/2025, “Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë”, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për regjistrimin, administrimin dhe mbrojtjen e patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë;

Duke pasur parasysh Ligjin nr. 43/2022, datë 21.04.2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, i cili përbën një nga aktet ligjore relevante për zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme;

Duke pasur parasysh rolin e DPPI-së në regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale dhe në ndërgjegjësimin e publikut dhe komunitetit të biznesit mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe përdorimit të pronësisë industriale;

Duke vlerësuar rëndësinë e inovacionit, pronësisë industriale, zhvillimit të sipërmarrjes dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare;

Duke vlerësuar nevojën për forcimin e lidhjeve ndërmjet aktorëve publikë, sektorit privat dhe rrjeteve të biznesit, me qëllim krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik;

Duke marrë në konsideratë se UNITA, sipas të cilit UNITA synon të funksionojë si një ekosistem (biznes me biznes) për lidhjen e bizneseve, krijimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe zgjerimin e bizneseve përtej tregjeve lokale, duke përdorur profile biznesi të verifikuara dhe mjete digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale;

Duke marrë në konsideratë fokusin e UNITA-s ndaj SME-ve, startup-eve, bizneseve të konsoliduara, eksportuesve, investitorëve dhe profesionistëve që synojnë zgjerimin në tregje të reja;

Me vullnetin e përbashkët për të zhvilluar bashkëpunim institucional në fushat me interes të përbashkët,

bien dakord si më poshtë:

NENI 1

OBJEKTI I MEMORANDUMIT

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi (“Memorandumi”) përcakton kuadrin e përgjithshëm të bashkëpunimit ndërmjet DPPI-së dhe UNITA-s në fushat e pronësisë industriale, inovacionit, zhvillimit të sipërmarrjes dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve.
2. Bashkëpunimi synon veçanërisht të kontribuojë në:
 - a) rritjen e ndërgjegjësimin të komunitetit të biznesit për rëndësinë e pronësisë industriale;
 - b) nxitjen e mbrojtjes dhe përdorimit strategjik të markave tregtare, patentave, modeleve të përdorimit, dizenjove industriale dhe objekteve të tjera të pronësisë industriale;
 - c) mbështetjen e SME-ve dhe startup-eve inovative;
 - ç) nxitjen e ndërkombëtarizimit dhe konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare;

- d) krijimin e mundësive për networking dhe partneritete ndërmjet bizneseve shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë;
- e) shkëmbimin e informacionit, eksperiencës dhe praktikave të mira në fushat me interes të përbashkët.

NENI 2

PARIMET E BASHKËPUNIMIT

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të udhëhiqet nga këto parime:


- a) respektimi i legjislacionit në fuqi;
- b) respektimi i kompetencave ligjore dhe institucionale të secilës Palë;
- c) transparenca dhe mirëbesimi;
- ç) respektimi i pavarësisë institucionale të DPPI-së dhe pavarësisë organizative dhe tregtare të UNITA-s;
- d) mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i subjekteve;
- e) mbrojtja e informacionit konfidencial dhe të dhënave personale;
- f) vullnetarizmi në pjesëmarrjen e bizneseve dhe subjekteve të tjera në aktivitetet që zhvillohen në kuadër të këtij Memorandumi.

NENI 3

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Palët synojnë të bashkëpunojnë, sipas mundësive dhe kompetencave të tyre, në fushat e mëposhtme:

1. Ndërgjegjësimi për pronësinë industriale, nëpërmjet aktiviteteve informuese, seminareve, workshopeve dhe materialeve edukuese;
2. Promovimi i inovacionit dhe sipërmarrjes, veçanërisht ndërmjet SME-ve dhe startup-eve;
3. Ndërkombëtarizimi i biznesit, duke promovuar përdorimin strategjik të pronësisë industriale në procesin e hyrjes në tregje të huaja;
4. Networking dhe partneritete, duke krijuar mundësi për lidhjen e bizneseve shqiptare me partnerë potencialë ndërkombëtarë;



5. Aktivitete dhe evente të përbashkëta, përfshirë konferenca, seminare, workshope, takime biznesi, forume dhe aktivitete të tjera;
6. Shkëmbimi i ekspertizës dhe informacionit, në përputhje me kompetencat dhe kufizimet ligjore të secilës Palë;
7. Digjitalizimi dhe teknologjitë e reja, përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale dhe të inteligjencës artificiale, kur kjo është e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
8. Çdo fushë tjetër që Palët e konsiderojnë me interes të përbashkët dhe e përcaktojnë me shkrim.

NENI 4

ANGAZHIMET E DPPI-së

Në kuadër të këtij Memorandumi dhe në përputhje me kompetencat e saj ligjore, DPPI synon:

- a) të kontribuojë në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere lidhur me pronësinë industriale;
- b) të ofrojë, sipas mundësive, ekspertizë institucionale në aktivitetet e dakordësuara;
- c) të promovojë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale për zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e biznesit;
- d) të identifikojë, së bashku me UNITA-n, tema dhe aktivitete me interes për komunitetin e biznesit;
- e) të marrë pjesë, sipas mundësive dhe autorizimeve përkatëse, në konferenca, seminare, workshope dhe aktivitete të tjera;
- f) të mbështesë përhapjen e informacionit të saktë dhe zyrtar mbi sistemin shqiptar të pronësisë industriale.

NENI 5

ANGAZHIMET E UNITA-s

Në kuadër të këtij Memorandumi, UNITA synon:

- a) të kontribuojë në krijimin e mundësive për networking ndërmjet bizneseve shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë;
- b) të promovojë, në kuadër të rrjetit të saj dhe sipas kriterëve të platformës, mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar për bizneset shqiptare;



- c) të lehtësojë, sipas mundësive, pjesëmarrjen e bizneseve shqiptare në aktivitete dhe evente
- d) të bashkëpunojë me DPPI-në në aktivitete që ndërthurin pronësinë industriale, inovacionin dhe ndërkombëtarizimin e biznesit;
- e) të ofrojë informacion mbi mundësitë e rrjetëzimit dhe partneritetit që ofron ekosistemi i saj;
- f) të kontribuojë në promovimin e kulturës së mbrojtjes së pronësisë industriale në komunitetin e biznesit.

NENI 6


AKTIVITETET E PËRBASHKËTA

1. Për zbatimin e këtij Memorandumi, Palët mund të organizojnë:
 - a) seminare dhe workshope;
 - b) konferenca dhe forume;
 - c) takime;
 - ç) aktivitete për SME-të dhe startup-et;
 - d) aktivitete mbi pronësinë industriale dhe inovacionin;
 - dh) aktivitete për ndërkombëtarizimin e bizneseve;
 - e) aktivitete të tjera të dakordësuara ndërmjet Palëve.
2. Aktivitetet konkrete, objektivat, afatet, përgjegjësitë dhe, kur është e nevojshme, kostot përkatëse mund të përcaktohen në plane pune, protokolle, anekse ose marrëveshje të veçanta.

NENI 7

PRONËSIA INDUSTRIALE

1. Asgjë në këtë Memorandum nuk përbën transferim, licencim ose dhënie të ndonjë të drejte mbi patentat, markat tregtare, disenjot industriale, të drejtat e autorit, know-how ose të drejta të tjera të pronësisë intelektuale të secilës Palë.
2. Çdo material, dokument, logo, markë, përmbajtje ose element tjetër i pronësisë intelektuale që i përket njëres Palë do të mbetet pronë e saj.
3. Përdorimi i logos, emrit ose identitetit vizual të njëres Palë nga Pala tjetër do të bëhet vetëm me miratim paraprak me shkrim.



NENI 8

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Palët angazhohen të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në veçanti **Ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**. Ky ligj përcakton rregullat për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
2. Çdo shkëmbim të dhënash personale në kuadër të këtij Memorandumi do të kryhet vetëm kur është i nevojshëm për një qëllim të përcaktuar dhe në përputhje me bazën ligjore përkatëse.
3. Palët marrin masat e përshtatshme teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale nga aksesimi, përdorimi, ndryshimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.
4. Në rast se një aktivitet i caktuar kërkon përpunim të të dhënave personale nga njëra Palë në emër të tjetrës, Palët do të përcaktojnë paraprakisht rolet, përgjegjësitë dhe kushtet e përpunimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 9

KONFIDENCIALITETI

1. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, kur ky informacion është përcaktuar si konfidencial ose kur natyra e tij kërkon trajtim konfidencial.
2. Detyrimi për konfidencialitet nuk zbatohet ndaj informacionit që:
 - a) është bërë publik në mënyrë të ligjshme;
 - b) ka qenë i njohur ligjërisht për Palën marrëse përpara marrjes së tij;
 - c) duhet të bëhet publik në zbatim të një detyrimi ligjor.
3. Dispozitat e këtij neni nuk kufizojnë detyrimet e DPPI-së lidhur me transparencën, të drejtën e informimit apo publikimin e informacionit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 10

PAVARËSIA INSTITUCIONALE DHE NATYRA E BASHKËPUNIMIT



1. Ky Memorandum nuk krijon marrëdhënie ortakërie, agjencie, përfaqësimi tregtar, sipërmarrjeje të përbashkët apo ekskluziviteti ndërmjet Palëve.
2. Ky Memorandum nuk transferon dhe nuk delegon kompetenca publike ose administrative të DPPI-së tek UNITA.
3. UNITA nuk do të interpretojë ose paraqesë këtë Memorandum si autorizim për të ushtruar kompetenca të DPPI-së ose për të vepruar në emër të DPPI-së.
4. DPPI nuk do të interpretohet, nëpërmjet këtij Memorandumi, si garantuese, certifikuese apo miratuese e produkteve, shërbimeve, platformës ose ofertave tregtare të UNITA-s.
5. Asnjë subjekt privat nuk fiton të drejtë preferenciale për shkak të këtij Memorandumi në procedurat, shërbimet apo aktivitetet administrative të DPPI-së.

NENI 11


DETYRIME FINANCIARE

1. Ky Memorandum nuk krijon, në vetvete, detyrime financiare për asnjërën Palë.
2. Çdo aktivitet që kërkon financim, pagesë, prokurim ose angazhim tjetër financiar nga DPPI do të jetë objekt i një marrëveshjeje të veçantë dhe do të kryhet vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe procedurat përkatëse.
3. Ky Memorandum nuk përbën detyrim për DPPI-në, punonjësit e saj apo subjektet e treta për të blerë, përdorur ose kontraktuar shërbimet tregtare të UNITA-s.
4. Pjesëmarrja e bizneseve në shërbimet tregtare të UNITA-s do të jetë vullnetare dhe do të rregullohet drejtpërdrejt ndërmjet biznesit dhe UNITA-s, sipas kushteve të përcaktuara prej tyre.

NENI 12

KOMUNIKIMI DHE PËRDORIMI I EMRIT TË PALËVE

1. Palët mund të publikojnë informacion lidhur me nënshkrimin dhe aktivitetet e këtij Memorandumi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Çdo përdorim i emrit, logos, stemës apo identitetit institucional të DPPI-së në materiale promocionale të UNITA-s kërkon miratim paraprak me shkrim nga DPPI.
3. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i emrit ose logos së UNITA-s nga DPPI do të bëhet me miratim paraprak nga UNITA.



4. Asnjë komunikim publik nuk duhet të krijojë përshtypjen se DPPI rekomandon, certifikon ose garanton shërbimet tregtare të UNITA-s.

NENI 13

KOORDINIMI I BASHKËPUNIMIT

1. Secila Palë cakton një person kontakti për koordinimin e zbatimit të këtij Memorandumi.

Për DPPI, caktohet Sektori i Koordinimit, Raportimit dhe Analizës dhe për Unita AL, caktohet Departamenti i Marketingut dhe Inovacionit.

2. Personat e kontaktit do të:

- a) identifikojnë aktivitetet me interes të përbashkët;
- b) koordinojnë komunikimin ndërmjet Palëve;
- c) propozojnë plane dhe aktivitete të përbashkëta;
- ç) ndjekin realizimin e aktiviteteve të dakordësuara.

3. Ndryshimi i personit të kontaktit mund të bëhet me njoftim me shkrim dhe nuk kërkon ndryshim të këtij Memorandumi.

NENI 14

EKSKLUZIVITETI

Ky Memorandum nuk ka karakter ekskluziv dhe nuk pengon asnjërën Palë të lidhë marrëveshje të ngjashme me institucione, organizata, kompani ose subjekte të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 15

PËRGJEGJËSIA

Secila Palë është përgjegjëse për veprimet dhe angazhimet e veta në kuadër të këtij Memorandumi.

Asnjëra Palë nuk është përgjegjëse për detyrimet kontraktore, financiare ose ligjore të Palës tjetër ndaj personave të tretë.

NENI 16

NDRYSHIMET DHE SHITESAT

1. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë Memorandum bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve.
2. Dokumentet shtesë që lidhen me zbatimin e këtij Memorandumi do të konsiderohen pjesë e bashkëpunimit vetëm pasi të jenë miratuar dhe nënshkruar nga përfaqësuesit përkatës.

NENI 17

KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët.
2. Memorandumi lidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
3. Memorandumi mund të rinovohet me marrëveshje me shkrim të Palëve.
4. Secila Palë mund ta përfundojë Memorandumin duke njoftuar Palën tjetër me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara.
5. Përfundimi i Memorandumit nuk prek aktivitetet e filluara dhe të dakordësuara përpara datës së përfundimit, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

NENI 18

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet fillimisht nëpërmjet konsultimeve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet Palëve, me synim arritjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim.

NENI 19

LIGJI I ZBATUESHËM

Ky Memorandum, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kompetencat ligjore të secilës Palë.



DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ky Memorandum shpreh vullnetin e Palëve për të bashkëpunuar në fushat e përcaktuara në të dhe nuk interpretohet si kontratë për furnizim mallrash apo shërbimesh.
2. Çdo angazhim që shkon përtej kuadrit të këtij Memorandumi do të rregullohet në një akt të veçantë, sipas rastit.
3. Në rast mospërputhjeje ndërmjet këtij Memorandumi dhe një marrëveshjeje të veçantë të lidhur me vonë ndërmjet Palëve, marrëveshja e veçantë do të zbatohet vetëm për çështjet që rregullon shprehimisht.
4. Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë, nga një për secilën Palë.

**PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË PRONËSISË
INDUSTRIALE (DPPI)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ZNJ. MARIA SOLIS KAPEDANI**



**PËR UNITA ALBANIA
DREJTOR EKZEKUTIV
Z. ARNOLD MIOLLI**



Tiranë, më 31/08 2026